



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 709/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.10.2017, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k., dhe ofertës të operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Halim Xhelo”, Vlorë”, me nr. REF-23261-08-07-2017, me fond limit 60,644,928 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “INERTI” sh.p.k
Adresa: Rr. “Avdyl Pajo”, L. “5 Maji”, pranë qendrës “Concord Center”, pallati “Inerti”, shkalla II, kati VI, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë.
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga: “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 08.08.2017 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Halim Xhelo”, Vlorë”, me nr. REF-23261-08-07-2017, me fond limit 60,644,928 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.

II.2 Në datën 30.08.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 12.09.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultojn si më poshtë vijon:

i.	”ELIRA” sh.p.k.& ”Alba Construction”	44,701,447 lekë pa tvsh	kualifikuar;
ii.	”Colombo” sh.p.k.	44,875,385 lekë pa tvsh	kualifikuar;
iii.	”AVDULI” sh.p.k.&”BAHAS” sh.p.k.	47,209,603 lekë pa tvsh	skualifikuar;
iv.	”Shendelli” sh.p.k.&”Boshnjaku-B” sh.p.k	47,265,684 lekë pa tvsh	skualifikuar;
v.	”JUNIK” sh.p.k	48,361,070 lekë pa tvsh	skualifikuar;
vi.	”Kevin Construction” sh.p.k	51,182,137 lekë pa tvsh	skualifikuar;
vii.	”Aurora Konstruksion” sh.p.k&”BE-IS” sh.p.k	52,706,574 lekë pa tvsh	skualifikuar;
viii.	”INERTI” sh.p.k	59,426,171 lekë pa tvsh	kualifikuar;

II.4. Në datën 19.09.2017 operatori ekonomik ankimues ”INERTI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k., dhe ofertës të operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1.Operatori ekonomik “Elira” Sh.p.k referuar dhe krahasuar me kriteret e percaktuara ne DST, ne dijenine tone nuk mund te plotesoje keto kriteret. Referuar ofertes se paraqitur jemi te bindur se ne pamundesit te permbushjes se ketyre kriteretve operatori ekonomik “Elira” ka nenshkruar nje kontrate te perkohshme. Nga te dhenat qe ne kemi marre ndermjet operateve ekonomik me te cilet kemi marrredhenie te gjate bashkepunimi, figuron se operatori ekonomik “Elira” ka nenshkruar nje kontrate te perkoshme bashkepunimi me shoqerine “ALBA Construction” Sh.p.k.

2.Referuar kriteretve jemi te bindur se pavaresisht se ne sistem mund te jete shoqeria “Elira” Sh.p.k perfaqesues me prokure i ketij bashkepunimi ne mendojme se kompania “Alba Cons.” thjesht ka ndihmuar me dokumenta tekniko ligjor shoqerine “Elira”. Besojme dhe jemi te bindur ketij mendimi pasi shoqeria “Alba Cons”, edhe pse nje shoqeri me kapacitete te medha ka mangesi ne plotesimin e ketyre kriteretve teknike. Nga bashkepunimi qe ne kemi patur me shoqerine “Alba Cons.” Sh.p.k jemi vene ne dijeni se ne kontraten e perkohshme qe kane nenshkruar, shoqeria “Elira” ka marre persiper 25 % te punimeve dhe shoqeria “Alba Cons.” ka marre persiper 75 % te punimeve. Nga eksperienca jone ne fushen e marreveshjeve te bashkepunimit te perkohshem per plotesim te dokumentacionit, si dhe ne detyrim te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”. i ndryshuar, gjate ndarjes se punimeve qe do te kryeje secila nga shoqerite paraqiten mosperputhje dhe ngateresa ne percaktimin e shumave perkatese. Jemi mese te bindur se nese krahasohet oferta ekonomike e paraqitur me preventivin e detajuar sipas zerave do te gjenden mosperputhje te shifrave dhe pjesemarrja ne kete procedure nuk do te jete me 25 % me 75 % por e ndryshme. Jemi mese te bindur se nje nga mosperputhjet qe ka ky bashkim i perkohshem eshte dhe fondi rezerve. te cilet ne preventivin perkates te detajuar per secilin operator qe do te realizoje ne kete objekt, nuk figuron te jete perlllogaritur. Mjafton kjo perlllogaritje si dhe mos perputhja e zerave sipas shumave te percaktuara ne preventiv me kontraten e bashkepunimit per te shpallur te papajtuar me ligjin dhe aktet nenligjore oferten e paraqitur nga ky bashkim i perkohshem.

3.Referuar kriteretve te percaktuara ne DST vleresojme se bashkimi i operateve ekonomik nuk ka paraqitur analize te zerave per te gjitha zerat e vendosur ne preventivin memec. Jemi te bindur se kjo analize nuk eshte nenshkruar nga te dy operateret ekonomik dhe padiskutim eshte haruar nje gjase e madhe e zerave perkates.

4.Referuar kriteretve te percaktuara ne DST nga informacionet e marra, rezulton se operatori ekonomik “Alba Cons.” nuk ka marre vertetim te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2017 prane bashkive perkatese qe ushtron apo ka ushtruar aktivitet. Nese do ti referohemi ekstraktit te qkr ne sistemin elektronik shoqeria “Alba Cons” figuron te kete ushtruar aktivitet ne disa bashki te vendit. Jemi mese te bindur se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vertetimin perkates per keto bashki.

5.Referuar puneve te ngjashme ne, nga perballje te meparshme neper procedura prokurimi, kemi dijeni se operatori ekonomik “Alba Cons” paraqet si pune te ngjashme realizimin e burgut Shkoder. Nga informacionet tona, rezulton se operatori nuk ka akt kolaudimi pasi autoritet e huaja nuk e njohin kete akt juridik. Por, ne zbatim te ligjit per rregullimin e territorit, ky eshte nje akt i detyrueshem ne Republiken e Shqiperise. Fakti qe autoritet e huaja nuk e njohin kete akt juridik nuk perben justifikim pasi pjesemarrja ne nje procedure publike prane Autoriteteve shqiptare nuk mund te perbeje shkak justifikimi. Pranimi i punes se ngjashme ne kete rast do te shkaktonte cenim te kushteve te barabarta dhe trajtim diskriminues per cdo operator te cilet marrin pjese ne procedurat e prokurimit. Akti i kolaudimit eshte element detyrues si per sektorin privat ashtu dhe per sektorin shteteror. Edhe pse operatori ekonomik justifikohet se ai objekt eshte marre ne dorezim, kjo nuk verteton se ai objekt eshte kolauduar dhe eshte ne perputhje me te gjitha specifikimet perkatese te

projektit. Mos marrja parasysh e ketij elementi perban shkak te rende dhe shkleje te normave ligjore te cilat garantojne barazi dhe paanshmeri.

6.Referuar licenses se firmes "Alba Cons", ne jemi te bindur se ky opertor, referuar dhe marreshjes se perkohshme te bashkepunimit, me ane te se ciles ka marre persiper volumin kryesor, duhet te kete ne licensen e tij arkitektin. Shoqeria ne fjale nuk e ka arkitektin e te pasqyruar ne license. KVO me ane te veprimit te kualifikimit te ketij operatori gjendet ne shkelje te rende pasi do te krijonte kushte diskriminuese per operatoren e tjere dhe favorizuese per kete operator.

7.Operatori ekonomik "Alba" duke qene se ka pjesen me te madhe te realizimit te punimeve duhet te kete ne stafin e saj ekspertin e licensuar te zjarrit. Nga njohurite tona prane kompanive certifikuese per kete fushe rezulton se ky operator nuk e permbush kete kusht.

8.Operatori ekonomik "Alba Cons." nuk permbush te gjithe punonjesit e kerkuar me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik. Shumica e deshmive ky operator i ka te skaduar ne afat.

9. Nga njohurite tona prane kompanive certifikuese ne fushen per punime ne lartesi dhe mbrojtjen dhe sigurise ne pune, rezulton se opertori ekonomik "Alba Cons." nuk ka ose i ka skaduar afati i certifikates se leshuar.

10. Referuar zerave per mjete dhe pajisje, si dhe ne zbatim te kontrates se bashkepunimit, operatori ekonomik "Alba Cons." duhet te kete dhe te plotesoje (e vertetuar me dokumentacion perkates) jo me pak se 75 % te zerave te percaktuar ne DST. Jemi te bindur se nga gjitha ato zera te vendosur ky operator duke qene se nuk eshte perfaqesues kryesor (edhe pse ka volumin me te madh!!) nuk ka paraqitur te gjitha dokumentat e nevojshem per mjete dhe ose pajisje si fadrome, vinc kulle, elektroorgano, zmerilatrice, makineri vijejimi, gazogjen, trapan, pompe suvatimi, elektrosaldatrice, zyre e levizshme, kokore, prozhektore, tabela, strukture sinjalistike.

11.Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk kane paraqitur dokumentacion perkates qe te vertetohet se kane mjete multifunksional me krah 10 m. Nga te dhenat tona, duke u interesuar prane shoqerive qe kane dhe mund te kene mjete te tilla ky bashkim nuk ka kerkuar kontrate qeraje te perkohshme.

12.Duke qene se perfaqesues me prokure eshte shoqeria "Elira" jemi te bindur se deklarata e qe duhet paraqitur per furnizimi te produkteve nuk eshte nenshkruar nga te dy operatoren ekonomik si dhe autorizimet e marra nuk jane specifikuar per te dy operatoren ekonomik.

13.Ju informojme se shoqeria "Inerti" Sh.p.k, me nje eksperience te gjate ne sektorin e punimeve civile si dhe investimeve ne ndertim, nga informacionet tona te marra me shoqeri te cilat bashkpunojne ngushte me ne fushen e prodhimit te bojrave, pretendojme se operatori ekonomik "Elira" Sh.p.k nuk permbush kriterin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht "Kapacitetit teknik", citojme: "Operatori ekonomik te paraqese nje dokument (certificate) nga organet te akredituara ku te vertetoje qe boja hidroplastike eshte boje ekologjike (ECO ne perputhje me standartet). Shënim: Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik cdo anetari grupit duhet te paraqese certifikatat perkatese. Referuar te dhenave tona, ne sektorin e prodhimit te bojrave, shoqeri te cilat do te mund te paraqesin certifikaten e cilesise ekologjike jane shoqeri si "DELTA", "DAST", "DeKoll", "Renova" apo "Vivechrom", shoqeri te cilat njihen per kapacitetet e tyre si dhe cilesine e certifikuar. Shoqeria "Inerti" Sh.p.k u intresua prane ketyre shoqerive prodhuese dhe jemi konfirmuar, ne cilesine e bashkpunimit qe kemi me keto shoqeri, se operatori ekonomik "Elira" Sh.p.k dhe "Alba Konstruktion" Sh.p.k nuk kane marre apo ti jete leshuar ndonje her autorizim nga keto kompani serioze, qe disponojne bojra ekologjike te certifikuara nga laboratore per bojra ECO (sipas standarteve) te kerkuara ne kriterin e mesiperm te Autoritetit kontraktor. Per sa jemi te bindur se opertori ekonomik "Elira" Sh.p.k ka paraqitur autorizim nga ndonje firm jo serioze e cila mund te jete thjesht nje distributor bojrash qe nuk disponon autorizim te ndonje prodhuesi serioz dhe aq me teper te kete paraqitur ne sistemin e prokurimeve elektronike

per kete procedure paraqese nje dokument (certifikate) nga organet te akredituara ku te vertetoje qe boja hidroplastike eshte boje ekologjike (ECO ne perputhje me standartet). Edhe nese mund te kete paraqitur ndonje certifikate jemi te bindur se katalogu, apo emri i kompanise se shenuar ne certifikate nuk perputhet me emrin e shoqerise qe ka dhene autorizim per furnizim te kompanise me bojra ECO. Sa i perket kriterit te mesiperm jemi te bindur se per shoqerine "Alba" nuk figuron te kete paraqitur kete certifikate sic kerkohet ne DST. Referuar shpjegimit te mesiperm besojme se tek deklarata e paraqitur per mallrat/apo pajisjet nuk eshte specifikuar emri i kompanise qe do te beje furnizimin me bojra.

1. Ju informojme se shoqeria "Inerti" Sh.p.k, me nje eksperience te gjate ne sektorin e punimeve civile si dhe investimeve ne ndertim, nga informacionet tona te marra me shoqeri te cilat bashkpunojne ngushte me ne fushen e prodhimit te bojrave, pretendojme se Operatori ekonomik "Colombo" Sh.p.k nuk permbush kriterin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht "Kapacitetit teknik", citojme: "Operatori ekonomik te paraqese nje dokument (certifikate) nga organet te akredituara ku te vertetoje qe boja hidroplastike eshte boje ekologjike (ECO ne perputhje me standartet). Referuar te dhenave tona, ne sektorin e prodhimit te bojrave, shoqeri te cilat do te mund te paraqesin certifikaten e cilesise ekologjike jane shoqeri si "DELTA", "DAST", "De Koll", "Renova" apo "Vivechrom" shoqeri te cilat njihen per kapacitetet e tyre si dhe cilesine e certifikuar. Shoqeria "Inerti" Sh.p.k u intresua prane ketyre shoqerive prodhuese dhe jemi konfirmuar, ne cilesine e bashkpunimit qe kemi me keto shoqeri, se operatori ekonomik "Colombo" Sh.p.k nuk ka marre apo ti jete leshuar ndonjeher autorizim nga keto kompani serioze, qe disponojne bojra ekologjike te certifikuara nga laboratore per bojra ECO (sipas standarteve) te kerkuara ne kriterin e mesiperm te Autoritetit kontraktor. Shoqeria jone nga informacionet e marra nga shoqeria "DEUTCH Color" se kane patur bashkepunim me shoqerine "Colombo". Nga te dhenat tona bashkepunuese me shoqerine "DEUTCH Color" per procedura te tjera prokurimi apo pune te realizuara ne ndertime civile jemi ne dijeni se kjo shoqeri nuk zoteron certifikate qe te vertetoje se boja e tyre eshte ECO. Keto certifikata leshohen nga laboratore te specializuar qe mund te jene te huaj ose shqiptar. Nje nga kompanite kryesore qe eshte e certifikuar nga shteti shqiptar eshte shoqeria "SGS" e cila zoteron laboratore dhe kapacitete per te kryer analiza te tilla. Nga te dhenat tona shoqeria "Colombo" do kete paraqitur ne vend te certifikates perkatese ECO thjesht skedat promocionale apo te katalogjeve qe hartohen nga vete kompanite me qellim marketingu. Keto skeda te leshuara nga distributor/prodhues te bojres nuk kane dhe nuk mund te vertetojne apo te jene ekuivalente me certifikata te leshuara nga organizma perkatese qe ne kete rast jane laborator te specializuar per leshimin e certifikatave ECO.

2. Nga informacionet tona te marra me shoqeri te cilat bashkpunojne ngushte me ne fushen e punimeve civile apo sektorin e ndertimit, mjeti i kerkuar nga autoriteti juaj kontraktor konkretisht "Kapacitetit teknik", citojme: "Mjet multi funksional telescopic, pirun ngrites 10 m dhe vinc (per montimin e konstruksioneve (ose vinc eskavator)", eshte mjaft i veshtire per tu gjendur dhe per tu dhene me qera nga shoqerite te cilat e disponojne. Nga te dhenat tona, duke u interesuar prane shoqerive qe kane dhe mund te kene mjete te tilla si dhe nga njohjet tona prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave na rezulton se firma "Colombo" apo "Laba 99" Sh.p.k nuk ka importuar mjet multifunksional apo vinc eskavator me krah jo me pak se 10 m, pasi per te tilla mjete importi eshte e nevojshme akti i zhdoganimit. Jemi te bindur se operatori ekonomik "Colombo" Sh.p.k ka paraqitur ndonje fature per pajisje si mjet teleskopik dhe jo makineri teleksopike multifunksionale si pirun dhe vinc me krah mbi 10 m. Referuar akteve perkatese ligjore te prokurimit publik per te vertetuar pronesine e makinerive kerkohen dokumente shoqeruese dhe jo

thjesht fatura tatimore. Per makinerite kerkohen akte zhdoganimi si dhe material shoqerues qe te specifikohen qarte karakteristikat e makinerise. Ne rastin konkret jemi te bindur se operatori ekonomik ka paraqitur ndonje fature, tatimore te leshuar nga shoqeria "Laba 99" ose "H.E.L.D.I. Construction Sh.p.k qe nga nje verifikim i thjesht ne sistemin e qkr ne objektin e shoqerise nuk figuron te kete shitje te pajisjeve apo makinerive por thjesht ndertim si dhe rikonstruksion. Shitja e nje makinerie e cila regjistrohet kerkohet me akt noterial prane noterit publik, kjo ne perputhje me ligjin per noterin. Fatura e paraqitur nuk verteton specifikimet teknike si krahe jo me pak se 10 m si dhe nuk mund te vertetohet se eshte mjet teleskopik pirun -Vinc) apo mjet teleskopik pirun + eskavator. Jemi mese te bindur se ky operator ka paraqitur nje deklarate fiktive e cila perben dhe shkelje me pergjegjesi penale per kete rast.

3. Nga njohurite tona prane kompanive certifikuese ne fushen per punime ne lartesi dhe mbrojtjen dhe sigurise ne pune, rezulton se operatori ekonomik "Colombo" nuk ka punonjes te certifikuar per "Mbrojtjen e shendetit dhe sigurise ne pune". Mos paraqitja e ketij dokumenti ngarkon me pergjegjesi te plote Komisionin e Vleresimit te Ofertave, pasi referuar ligjit te prokurimit publik, operatori ekonomik kualifikohet vetem nese ka plotesuar te gjitha kriteret e percaktuara ne DST.

4. Operatori ekonomik Colombo per makinerin e vijeimit jemi te bindur se ka paraqitur fature te thjesht tatimore nga shoqeria "Laba 99" Sh.p.k ose "H.E.L.D.I Construction" Sh.p.k. Bazuar nga nje kerkim ne qkr del se me date 25.03.2010 emri i kompanise nga "Laba 99" u be "H.E.L.D.I." Sh.p.k. Per cdo suate qe ky operator gjendet ne pamundesi per te plotesuar kriteret te vendosura nga Autoritetet Kontraktor, paraqet fatura nga keto dy kompani te mesiperme. Kerkojme nga autoriteti juja te beje nje hetim administrativ pasi me siguri ky operator do te kete vendosur data fiktive te fatures qe nuk korespondojne me emrin e shoqerise sipas ekstraktit historik te saj. Qartazi kemi te bejme me nje fature fiktive dhe operatori ekonomik gjendet ne kushtet e mashtrimit. Referuar ligjit per TVSH subjektet sh.p.k jane pjese e tvsh-se. Fatura e thjeshte tatimore leshohet nga subjektet qe nuk jane pjese e tvsh. Pra, kemi te bejme me rast te leshimit te nje fature ne emer te nje shoqerie qe nuk perputhen datat me emrin e shoqerise si dhe nuk eshte ndjekur rruga ligjore per tvsh-ne. Nese kjo fature e thjesht tatimore eshte shoqeruar me foto perkatese jemi te bindur se foto eshte e shkarkuar nga google. Mjafton te behet nje search nese eshte ose je e shkarkuar menyre kerkimi ne google: marking road machine sektori "Images".

5. Referuar kapaciteteve te firmes vleresoj me se operatori ekonomik "Colombo" nuk ka ne stafin e tij 9 elektricista te pajisur me IQT te punesuar dhe qe te figurojne ne listepagesat e shoqerise.

6. Referuar kapaciteteve te firmes vleresoj me se operatori ekonomik "Colombo" nuk ka ne stafin e tij 2 specialist ndertimi te pajisur me IQT te punesuar dhe qe te figurojne ne listepagesat e shoqerise.

7. Mendojme se operatori ekonomik "Colombo" nuk ka mjetet e mjaftueshme si kamiona dhe kamioncina per te realizuar kete objekt. [...]"

II.5. Nga verifikimet e kryera ne dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 7981/2 Prot. datë 25.09.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes "INERTI" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e tij për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 05.10.2017 pala ankimese "INERTI" sh.p.k, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7.Në datën 16.10.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.9302/1prot., datë 11.10.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *“4.Referuar kriterëve të percaktuara në DST nga informacionet e marra, rezulton se operatori ekonomik ”Alba Cons.” nuk ka marre vertetim të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2017 prane bashkive perkatese që ushtron apo ka ushtruar aktivitet. Nese do të referohemi ekstraktit të qkr në sistemin elektronik shoqëria ”Alba Cons” figuron të kete ushtruar aktivitet në disa bashki të vendit. Jemi mese të bindur se oepratori ekonomik nuk ka paraqitur vertetimin perkates për keto bashki.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.2 gërma d., të shtojcës 10, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Vertetim se i ka shlyer taksat vendore për vitin 2017 të shoqëruar me faturen perkatese të pageses (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar sipas kërkesave të mesiperme)”

III.1.2.Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...].”*

III.1.3.Pika 2 e nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikon: *“[...]Detyrimi i taksës për t’u paguar nga çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit, që kryhet në kohën e regjistrimit dhe reregjistrimit të tij[...].”*

III.1.4. Në nenin 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se: *“3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të percaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.”*

III.1.5.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se pjesëtari i bashkimit të operatorëve “Alba Construction” sh.p.k, nuk ka dorëzuar asnjë dokument që të vërtetojë shlyerjen e të gjitha taksave vendore për vitin 2017, në plotësim të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2 gërma d., të shtojcës 10, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Paraqitja e vërtetimeve vetëm nga njëri prej pjesëtarëve të këtij bashkimi operatorësh (ELIRA shpk), nuk e përmbush kriterin e sipërcituar, pasi në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, duhet të dëshmojnë se kanë shlyer detyrimet mbi taksat vendore të gjithë pjesëtarët e bashkimit dhe jo vetëm njëri prej tyre. Vlen të theksohet se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, bazuar në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenin 74 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KPP gjykon se BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k. nuk e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2 gërma d., të shtojcës 10, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, e për pasojë autoriteti kontraktor duhet ta skualifikoj këtë bashkim operatorësh ekonomik.

Sa më sipër, pretendimi mësipërm i operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k qëndron.

III.1.6.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi BOE “ELIRA” sh.p.k., & “Alba Construction” sh.p.k. nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se *“Operatori ekonomik “Colombo” Sh.p.k nuk përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht “Kapacitetit teknik”, citojme: “Operatori ekonomik te paraqese nje dokument (certifikate) nga organet te akredituara ku te vertetoje qe boja hidroplastike eshte boje ekologjike (ECO ne perputhje me standartet)”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në pikën 2.3.13, të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon: *“13.Operatori ekonomik te paraqese nje dokument (certifikate) nga organet te akredituara ku te vertetoje qe boja hidroplastike eshte boje ekologjike (ECO ne perputhje me standartet).”*

III.2.2.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k, ka dorëzuar:

1. Kontratë furnizimi, datë 15.02.2016, lidhur ndërmjet shoqërisë “DEUTSCHCOLOR” sh.a. (Sipërmarrës) dhe shoqërisë “Colombo” sh.p.k. (Porositës), me objekt “Furnizim boje muri të të gjitha llojeve, bojë hekuri, grafiato, primer(astar), stuko patinimi”;
2. Certifikatë EN ISO 9001:2008 lëshuar për DEUTSCHCOLOR sh.a. “Projektim, prodhim dhe shpërndarje bojra dhe llaqe” (1 në gjuhën shqipe dhe 1 në gjuhën angleze).
3. Katalog për tre lloje të ndryshme bojrash DEUTSCHCOLOR.

III.2.3.Në nenin 46 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese[...]

III.2.4. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.2.5. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k, ka dorëzuar certifikatë të menaxhimit të cilësisë EN ISO 9001:2008 lëshuar për DEUTSCHCOLOR sh.a. “Projektim, prodhim dhe shpërndarje bojra dhe llaqe”. KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite se për të vërtetuar që boja

hidroplastike është bojë ekologjike (ECO në përputhje me standartet), operatorët ekonomik duhet të paraqesin një certifikatë nga organe të akredituara për certifikimin e këtij standarti. Bazuar në standartet kombëtare dhe ndërkombëtare, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se certifikimi për menaxhimin e cilësisë EN ISO 9001:2008 nuk mund të konsiderohet ekuivalent me standartin ekologjik ECO, pasi janë dy standarte të ndryshme nga njëra-tjetra. Gjithashtu, vlen të theksohet se, pavarësisht se në katalogët e paraqitur në mënyrë elektronike nga operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. konstatohet se boja e ofruar është ekologjike, nuk e përbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.13, të shtojcës 10, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pasi autoriteti kontraktor ka specifikuar dokument të posaçëm për përmbushjen e këtij kriteri. KPP vlerëson të theksojë se është në të drejtë të autoritetit kontraktor, i cili në kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkojë dokumentacion provues për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik ofertues “Colombo” sh.p.k, nuk e ka përmbushur kriterin e sipërcituar të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi dokumentacioni i dorëzuar prej tij nuk është në përputhje me kërkesat dhe formën e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, pretendimi mësipërm i operatorit ekonomik ankimues “INERTI” sh.p.k qëndron.

III.2.8.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomikë ankimues “INERTI” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “INERTI” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Halim Xhelo”, Vlorë”, me nr. REF-23261-08-07-2017, me fond limit 60,644,928 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. dhe BOE “ELIRA” sh.p.k. & “Alba Construction” sh.p.k. si dhe të korrigjojë shkeljet, duke i skualifikuar këta operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INERTI” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1559 protokoli Datë 05.10.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

